DALËSE-IZLAZNA-OUTGOING
REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS/VLADA KOSOVA/GOVERNMENT OF KOSOVA
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. 020-303/6
Data 21.04.2021 -VI-

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova-Republic of Kosovo
## Qeveria - Vlada – Government

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

| | | |
|---|---|---|
| Për: | **Bekim Jashari,** Kryetar i Komunës së Skenderajt<br>**Fatbardha Haliti,** Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Skenderajt | |
| Kopje: | Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL<br>Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë | |
| Përmes: | **Elbert Krasniqi,** Ministër i MAPL-së<br>**Trim Berisha,** Zv. Sekretar i Përgjithshëm në MAPL | |
| Nga: | **Venera Çerkini,** Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave | Datë: 16.04.2021<br>Nr.020-303 |
| Zyrtaret përgjegjës:<br>1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor<br>2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor | Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave<br>Vjosa Ahmetaj, Zyrtare e lartë për monitorim të komunave | |
| Lënda: | Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Skenderajt | |
| Lloji i aktit: | □ Vendim i Kuvendit të Komunës | |

I nderuar Kryetar,
E nderuara Kryesuese,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2021 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

| |
|---|
| Vendim i Kuvendit të Komunës Nr. 01-463/02-0017017/21 për korrigjimin e Vendimit nr. 01-463/02-0067155/19 i dt. 05.11.2019 |
| I miratuar më datë: 31.03.2021 |
| I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 06.04.2021 |

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural **<u>është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi</u>**.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejmë në lidhje me këtë vlerësim.

DALËSE-IZLAZNA-OUTGOING
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. / Br. / No. 020-303/6
-VI-
Data / Datum / Date 21.04.2021

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**
**Qeveria - Vlada - Government**

*Ministria e Admininistrimit te Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

| | | |
|---|---|---|
| Za : | **Bekim Jashari**, gradonačelnik opštine Srbica<br>**Fatbardha Haliti**, predsedavajuća Skupštine opštine Srbica | |
| Kopija: | Jedinici za administraciju dokumenata u MALS-u<br>Jedinici za administraciju dokumenata u opštini | |
| Preko: | **Elbert Krasniqi**, ministar MALS-a<br>**Trim Berisha**, zamenik generalnog sekretara MALS-a. | |
| Od: | **Venera Çerkini**, rukovodilac Pravnog odeljenja monitorisanje opština, MALS | Dana, 16.04.2021. Br.020-303 |
| Službenik za kontolu: | Xhevat Tafa, rukovodilac Odseka za monitorisanje opština | |
| Službenik-ca za izradu: | Vjosa Ahmetaj, viša službenica za monitorisanje opština | |
| Predmet: | Zahtev za razmatranje zakonitosti akta Skupštine opštine Srbica | |
| Vrsta akta: | Odluka skupštine opštine | |

Uvaženi gradonačelniče,
Uvažena predsedavajuća,

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 10/2019 o administrativnom razmatranju akata opština i na osnovu zakonskih ovlašćenja određenim osnovnim zakonima i Uredbom Vlade br. 02/2021 o oblastima odgovornosti administrativne Kancelarije premijera i ministarstva, Pravno odeljenje i monitorisanje opština MALS-a, primilo je za obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

| |
|---|
| Odluka skupštine opštine br. 01-463/02-0017017/21 za ispravku odluke br. 01-463/02-0067155/19 od dana, 5.11.2019. |
| Usvojena dana, 31.03.2021. |
| Predložena na razmatranje u MLS-u, dana, 6.04.2021. |

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, procenjuje da je opštinski akt iz **proceduralnog aspekta u saglasnosti** sa zakonskim odrebama zakonodavstva na snazi.

Ministartsvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za dodatna objašnjenja u vezi sa ovom procenom.

Nr. 01-463/02-0017017/21

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal / Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije / Ministry of Local Government Administration
Data / Datum / Date 06-04-2021
-VI- 020-303

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

**Kuvendi i Komunës/ Skupstina Opstine/Municipal Assambly**

Në bazë të nenit 11, 12 par. 1, 2 shkronja d), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040, qershor 2008, neni 50 par. 1, 2 i Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative nr.05/L-031, neni 14 par. 1,2 shkronja d) i Statuti të Komunës nr. 01-110-385, i dt.03.12.2008, Kuvendi i Komunës së Skenderajt, në mbledhjen e rregullte të mbajtur me datën 31.03.2021 miratoi këtë:

# VENDIM

(Për Korigjimin e vendimit nr.01-463/02-0067155/19, i dt.05.11.2019)

**Neni 1**

Miratohet propozim-vendimi me nr.05-463/02-004572/21, të dt.22.03.2021, për korrigjimin e vendimit me nr.01-463/02-0067155/19, i dt.05.11.2019, për shpalljen e zonave me interes publikë, i nxjerrë nga kuvendi komunal Skenderaj.

**Neni 2**

Korigjohet neni 4 i vendimit nr.01-463/02-0067155/19, i dt.05.11.2019, i hiqen ngastra si:

- Ngastra me nr.**P-72015018-01430-0**, më kulturë kullosë, klasa e 3 (tretë), më sipërfaqe të përgjithshme prej **00.15.50ha**, zona kadastrale Klinë e Epërme.
- Ngastra me nr.**P-72015018-01431-0**, më kulturë arë, klasa e 5 (pestë), më sipërfaqe të përgjithshme prej **00.14.81ha**, zona kadastrale Klinë e Epërme.
- Ngastra me nr.**P-72015018-01432-0**, më kulturë arë, klasa e 5 (pestë), më sipërfaqe të përgjithshme prej **10.69.69ha**, zona kadastrale Klinë e Epërme.

**Neni 3**

Ngastrat kadastrale të cekura në nenin 2 të këtij vendimi hiqen nga vendimi nr.01-463/02-0067155/19, i dt.05.11.2019, i nxjerr nga kuvendi komunal Skenderaj, pjesa tjetër e vendimit mbesin të pa ndryshuar, dhe në fuqi.

**Neni 4**

**Bashkangjitur këtij vendimit:**

- Kontrata nga AKP-ja, nr.1634, numër rendor 17, me dt.27.04.2020,
- Vërtetimi i noterit nr.4731/2020,
- Certifikata nr.562/20, dt.14.04.2020, lëshuar nga agjensioni kadastral,
- Kopja e planit nr.562/20,dt.14.04.2020, lëshuar nga agjensioni kadastral,
- Njoftimi i fituesit nr.305 numri i fq.2, i dt. 21.01.2021,
- Fatura nr.288/20,
- Kopja e letërnjoftimit,
- Vendimi i Kuvendit.

**Neni 5**

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë.

**Neni 6**

Ky vendim hyn në fuqi, 15 dite pas regjistrimit në zyrën e regjistrimit te protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit te tij ne ueb – faqen e komunës.

**Vendimi i Dërgohet :**
1x1 Arkivit
1x1 MPL-së
1x1 Zyrës së Kryetarit
1x1 DGJKP-së
1x1 Dosjes

**Kryesuesja e KK-së;**
**Znj. Fatbardha Haliti**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
SKENDERAJ
Nr./No. 01-463/02-0017017/21
Data 02.04.2021

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality Skenderaj

Kuvendi i Komunës/Skupstina Opstine/Municipal Assembly

Na osnovu člana 11, 12, stav 2, slovo d), Zakona o Lokalnoj Samoupravi br. 03/L-040 Juni 2008.člana 50 Zakona o Opštem Upravnom Postupku br. 05/L-092, kao i člana 14 stavka 1 i 2 slovo d) Statuta opstine Skenderaj br.01-110-385 datum 03.12.2008, Skupština Opštine Skenderaj, na svojoj redovnoj sednici održanu datum: 29.01.2021, usvaja sledeću:

# ODLUKU

## Za koregovanje odluke br. 01-463/02-0067155/19 od dana 05.11.2019 godine

### Član 1

**Usvaja se** Nacrt-Odluka br. 05-463/01-004572/21, od dana 22.03.2021 godine za koregovanje odluke br. . 01-463/02-0067155/19 od dana 05.11.2019 godine za objavljivanje zona od javnog interesa, donosena od Skupstina Opstine.

### Član 2

Korigira se clan 4 odluke br. 01-463/02-0067155/19 od dana 05,11.2019 godine, ukolne se sledese parcele:

- Parcela br. P-72015018-01430-0, sa kulutrom pasnjak, pete (5) klase u ukupnoj povrsini od 00.14.81 ha, kadastralna zona Gornja Klina;
- Parcela br. P-72015018-01430-0, sa kulutrom njiva, pete (5) klase u ukupnoj povrsini od 00.15.50 ha, kadastralna zona Gornja Klina;
- Parcela br. P-72015018-01430-0, sa kulutrom njiva, pete (5) klase u ukupnoj povrsini od 10.69.69 ha, kadastralna zona Gornja Klina;

### Član 3

Kadastralne parcele pomenute u clanu 2 ove odluke uklonu se od odluke br. 01-463/02-0067155/19 od dana 05.11.2019 godine, donosena od skupstina opstine Skenderaj, ostali deo odluke ostaje neizmenjen i na snazi.

### Član 4

Prilozeno odluci:

- Ugovor br. 1634 od AKP-a, pod rednim brojem 17, od dana 27.04.2020;
- Odluka od notara br. 4731/2020;
- Uverenje br. 562/20 od dana 14.04.2020, izdata od Kadastralne Agencije;
- Kopije Plana br. 562/20 od dana 14.04.2020, izdata od Kadastralne Agencije;
- Obave[tenje dobitniku br. 305, broj stranica 2 od dana 21.01.2021 godine;
- Kopije Licne Karte;
- Odluka Skupstine.

**Clan 5**

Sprovođenje ove odluke su dužni da izvrše: Direkcija za Geodezije Kadastër i Imovine.

**Clan 6**

Ova odluka stupa na sangu 15 dana posle registracije u kancelariju za protokol MALS-a, i objavljivanja na oba službena jezika u ueb stranicu opštine.

**Odluka se dostavlja**:
1x1 Arhivi;
1x1 Kabinetu predsednika;
1x1 DGKIg .
1x1 DUZS-u;
1x1MALS_u
1x1 Dosiji.

Presedavajuća SO-a;
Gđa: Fatbardha Haliti

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL/ASSEMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPŠTINA OPŠTINA
SKENDERAJ
Nr. 05-463/02-0045712/21
Data 22-03-2021

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova
Republic of Kosovo

**Komuna Skënderaj**
Opshtina Skenderaj
Municipality of Skenderaj

**Drejtoria për Gjeodezi Kadaster dhe Pronësi**
Departament of Geodesy and Property Cadastre
Direkcia za Geodeziu Kadaster I Imovi

| | |
|---|---|
| DATË/A: | 22/03/2021 |
| REFERENC-Ë | |
| PËR/ZA/ TO: | KOMITETIN PËR POLITIKË E FINANCA KUVENDIT TË KOMUNËS SË SKENDERAJT Kryesues znj.**Fatbardha Haliti** |
| CC: | Kryetarin e Komunës Skenderaj **Z. Bekim Jashari** |
| PËRMES/PREKO/THROUGH : | Arkivës |
| NGA/OD/FROM: | Drejtori I Drejtorisë për Gjeodezi Kadastër dhe Pronësi, **Ramiz Shala** |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Propozim Vendim |

Në mbështetje të nenit 12 pika 12.1, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës se Kosoves,Nr.28/ dt.04 Qershor 2008, nenit 24 pika 3,4,5 dhe 6, nenit 27 pika 1,2,3 të Ligjit për Dhënjën në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës se Paluajtshme të Komunës Nr.06/ L-092, Gazeta Zyrtare e Republikës se Kosovës, Nr.10/03,20019, Ligji Nr. 05/L - 031 PËR PROCEDURËN E PËRGJITHSHME ADMINISTRATIVE GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 20 / 21 QERSHOR 2016, PRISHTINË, nenin 50,50.1 pika I, e Statutit të Komunës se Skenderajt Nr.110-385,dt 03.12.2008, Kuvendit të Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me datë .________, I propozojnë këtë :

**PROPOZIM- VENDIM PËR KORIGJIMIN E VENDIMIT 01-463/02-0067155/19 I DATES 05./ 11./ 2019**
**PËR SHPALLJËN ZONA ME INTERES PUBLIK**

**NENI 1**

Me këtë vendim KORIGJOHET VENDIMI numër **01-463/02-0067155/19 I DATES 05./ 11./ 2019** i nxerrur nga Kuvendi për Shpalljen Zonave me Interes publik .

**NENI 2**

Nga Vendimi i Kuvendit me numer 01-463/02-0067155/19 I DATES 09./ 11./ 2019 hiqen Ngastrat e poshtëshënuar:

- **Ngastraë me Numer .P-72015018-01430-0** me kulturë kullosë ,klasa e 3 (tretë), me sipërfaqe .00.15.50 ,ha, Zona Kadastrale. Kline e EPËRM.
- **Ngastrën Numer. P-72015018-01431-0** , me kulturë arë, klasi 5 ( pestë), me sipërfaqe të përgjithshme prej 00.14.81, ha, Zona Kadastrale Klinë e Epërm.
- **Ngastrën Numer. P-72015018-01432-0** me kulturë arë , klasi 5 (pestë), me sipërfaqe. 10.69.69 ha, Zona Kadastrale Klinë e Epërm.

**NENI 3**

**3.1** Ngastrat kadastrale të cekura ne nenin 2 të këtij propozim vendimi , hiqen nga Venidmi i Kuvendit **01-463/02-0067155/19 I DATES 05./ 11./ 2019**

**3.2** Drejtoria e Gjeodezisë Kadastrit dhe Pronësisë në Komunën e Skenderajt obligohet ta zbatoj këtë vendim nga titullarët e mëparshëm te pronari ngastrat e cekura ne ketë vendim në sipas legjislacionit në fuqi.

**NENI 4**

Ky vendim hyn në fuqi pas nënshtrimit të detyrueshëm të ligjshmërisë sipas legjislacionit ne fuqi dhe 8 dit pas publikimit në Webfaqën e Komunës dhe tabelën e shpalljeve të Kuvendit të Komunës.

I dërgohet:
Arkivit
Kryetari te Komunës
Komitetit për Politikë dhe Financa
Kuvendit Komunal
Drejtorisë Së Gjeodezisë Kadastrit dhe Pronësisë

Bashkangjitur:
1. Kontrata nga AKP-ja numër 1634 numër rendor 17 data 27 prill 2020.
2. Vertetimi i noterit numër 4731/2020.
3. Certifikata numër 562/20 e datës 14./ 04./ 2020 lëshuar nga agjensioni kadastral
4. Kopja e Planit numër 562/20 e datës 14./ 04./ 2020 lëshuar nga agjensioni kadastral.
5. Njoftimi i fituesit numër 305 numri i faqes 2 i datës 21./ 01./ 2021.
6. Fatura numër 288/20.
7. Kopja e letërnjoftimit
8. Vendimi i Kuvendit

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Kuvendi i Komunës/Skupstina Opstine/Municipal Assambly

Pas shqyrtimit të propozim-vendimit nr.05-463/01-0063391/19, të dt.14.10.2019, në bazë të dispozitave të nenit 12 par 1,2 shkronja d, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040, qershor 2008, neni 27 par.1,2,3 të Ligjin nr.06/L-092 për dhënie në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës, neni 14 par. 1,2 shkronja d, të Statutit të Komunës së Skenderajt nr. 01-110-385, i dt.03.12.2008, Kuvendi i Komunës së Skenderajt, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 30.10.2019 miratoi këtë:

# VENDIM
# PËR SHPALLJEN E ZONAVË ME INTERES PUBLIK

I

Miratohet propozim-vendimit nr. 05-463/01-0063391/19, të dt.14.10.2019, për shpalljes së zonave me interes publik. Me këtë vendim shpallen zona me interes publik ngastrat e poshtëshënuar të cilët udhëheqin në emër të titullarëve të tyre në ZK. Skenderaj, Prekaz i Poshtëm, Prekaz i Epërm, Klinë e Mesme, Klinë e Epërm, Polac i Ri, Burojë, Runik dhe Bajë.

II

**Fabrika e Municionit të Gjuetisë Trepça Zona Kadastrale Skenderaj.**
Ngastra nr.281-3, më kulturë kullos, klasa e 3, me sipërfaqe 00.84,44 ha,
Ngastra nr.281-2, më kulturë kullos, klasa e 3, me sipërfaqe 01.23,65 ha,
Ngastra nr.548-1, më kulturë arë, klasa e 4, me sipërfaqe 00.51,20 ha,

**Pasuri Shoqërore Drejtoria e Pyjeve Zona Kadastrale Skenderaj.**
Ngastra nr.275, më kulturë kullos, klasa e 3, më sipërfaqe 01.17.24 ha,
Ngastra nr.278-1, më kulturë male, klasa e 3, më sipërfaqe 25.08.15 ha,
Ngastra nr.527-1, më kulturë kullos, klasa e 3, më sipërfaqe 00.06.51 ha,
Ngastra nr.793-3, më kulturë kullos, klasa e 3, më sipërfaqe 00.08.40 ha.

**Pasuri Shoqërore Drejtoria e Pyjeve Zona Kadastrale Prekaz i Poshtëm.**
Ngastra nr.590, më kulturë kullos, klasa e 3, më sipërfaqe 00.76.17 ha.
Ngastra nr.593, më kulturë kullos, klasa e 2, më sipërfaqe 01.68.80 ha.
Ngastra nr.604, më kulturë kullos, klasa e 2, më sipërfaqe 01.89.83 ha.

III

Ngastra kadastralë të cekura në nenin 2 të këtij vendimi janë në mbrojtje zonë të veçantë të Kompleksit Përkujtimorë "Adem Jashari" në Prekaz, i cili ka rëndësi ontologjike, antropologjike, historike edhe të trashëgimisë kulturore për qytetaret e Republikës së Kosovës. Ligji nr.2004/39 për Shpalljen e Kompleksit Përkujtimor "Adem Jashari" në Prekaz më Interes të Veçante Kombëtar, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës viti III/nr.23/01 prill 2008.

IV

**O.P.B. "Produkt" Zona Kadastrale Prekaz i Epërm**
Ngastra nr.1441, më kulturë arë, klasa e 4, më sipërfaqe 09.64.00 ha,
Ngastra nr.1442, më kulturë jo pjellore, më sipërfaqe 00.04.78 ha,
Ngastra nr.1443, më kulturë jo pjellore, më sipërfaqe 00.12.35 ha,
Ngastra nr.1825, më kulturë livadhe, klasa e 5, më sipërfaqe 00.44.56 ha,
Ngastra nr.1826, më kulturë arë, klasa e 5, më sipërfaqe 00.12.42 ha,
Ngastra nr.1827, më kulturë arë, klasa e 5, më sipërfaqe 00.38.26 ha,
Ngastra nr.1828-1, më kulturë arë, klasa e 5, më sipërfaqe 01.91.78 ha,
Ngastra nr.1828-2, më kulturë arë, klasa e 5, më sipërfaqe 00.08.51 ha.

**O.P.B. "Produkt" Zona Kadastrale Klinë e Mesme**
Ngastra nr.150, më kulturë arë, klasa e 4, më sipërfaqe 25.99.71 ha,
Ngastra nr.151, më kulturë rrugë, më sipërfaqe 00.22.25 ha,
Ngastra nr.152, më kulturë kullos, klasa e 2, më sipërfaqe 00.43.64 ha,
Ngastra nr.153-1, më kulturë arë, klasa e 5, më sipërfaqe 06.62.80 ha,
Ngastra nr.154, më kulturë kullos, klasa e 2, më sipërfaqe 00.24.06 ha,
Ngastra nr.155, më kulturë jo pjellore, më sipërfaqe 00.44.19 ha,
Ngastra nr.156, më kulturë kullos, klasa e 2, më sipërfaqe 00.36.55 ha,
Ngastra nr.157, më kulturë jo pjellore, më sipërfaqe 00.02.30 ha.

**O.P.B. "Produkt" Zona Kadastrae Klinë e Epërm**
Ngastra nr.647-2, më kulturë mal, klasa e 2, më sipërfaqe 00.57.04 ha,
Ngastra nr.1064, më kulturë arë, klasa e 5, më sipërfaqe 00.22.51 ha,
Ngastra nr.1430, më kulturë kullos, klasa e 3, më sipërfaqe 00.15.50 ha,
Ngastra nr.1431, më kulturë arë, klasa e 5, më sipërfaqe 00.14.81 ha,
Ngastra nr.1432, më kulturë arë, klasa e 5, më sipërfaqe 10.69.69 ha.

**O.P.B. "Produkt" Zona Kadastrale Polac i Ri**
Ngastra nr.132, më kulturë arë, klasa e 5, më sipërfaqe 00.47.45 ha,
Ngastra nr.133, më kulturë arë, klasa e 5, më sipërfaqe 02.04.02 ha,
Ngastra nr.333, më kulturë arë, klasa e 5, më sipërfaqe 00.77.04 ha,
Ngastra nr.90, më kulturë arë, klasa e 5, më sipërfaqe 01.64.68 ha.

**O.P.B. "Produkt" Zona Kadastrale Burojë**
Ngastra nr.684, më kulturë arë, klasa e 4, më sipërfaqe 00.19.41 ha,
Ngastra nr.685, më kulturë kullos, klasa e 4, më sipërfaqe 01.13.31 ha,
Ngastra nr.686, më kulturë kullos, klasa e 4, më sipërfaqe 00.14.01 ha.

**Kooperativa Bujqësore Zona Kadastrale Runik**
Ngastra nr.850, më kulturë kullos, klasa e 3, më sipërfaqe 00.37.45 ha,
Ngastra nr.852-1, më kulturë tokë ndërtimore-oborre, më sipërfaqe 00.53.15 ha,
Ngastra nr.1074, më kulturë kullos, klasa e 3, më sipërfaqe 00.24.41 ha.

**O.P.B. "Produkt" Zona Kadastrale Bajë**
Ngastra nr.2495, më kulturë arë, klasa e 3, më sipërfaqe 00.17.40 ha,
Ngastra nr.2496, më kulturë arë, klasa e 3, më sipërfaqe 00.10.66 ha,

V

Ngastra kadastralë të cekur në nenin 4 të këtij vendimi kërkohet për qellim të interesit publik në avancimin e mirëqenies së përgjithshme ekonomike kulturore e të trashëgimisë, zhvillimit ekonomik dhe infrastrukturës sociale (Shkolla, Kopshte për Fëmijë, Industri, Prodhim) të qytetarëve të Komunës së Skenderajt.

VI

Zbatimin e këtij vendimi do ta bëjë Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë.

VII

Ky vendim hyn në fuqi, 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së, si dhe publikimit të tij në ueb – faqen e Komunës.

**Vendimi i Dërgohet :**
**1x1 Arkivit**
**1x1 MAPL-së**
**1x1 Zyrës së Kryetarit**
**1x1 DGJKP-së**
**1x1 Dosjes**

**Kryesuesja e KK-së;**
**Dr. Fatbardha Haliti**

REPUBLIKA E KOSOVËS • KOMUNA E SKENDERAJT • REPUBLIC OF KOSOVO • MUNICIPALITY OF SKENDERAJ • REPUBLIKA KOSOVA • SKUPŠTINA OPŠTINA SKENDERAJ

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT - KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO
Nr. / Br. / No. II 1634
Nr. i Fq. / Br. Str. / No. Pg. 17
Data / Datum / Date: 27 APR 2020
Prishtinë / Pristina

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

# KONTRATË PËR SHITJEN DHE BARTJEN E PRONËS

Palë në këtë Kontratë janë:

A AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT (më tej e referuar si "AKP"), organ i pavarur publik i themeluar në bazë të Ligjit Nr. 03/L-067, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-034 ("Ligji mbi AKP"), i datës 21 shtator 2011, që vepron si administratore me mirëbesim në emër të ndërmarrjes së identifikuar në Shtojcën 1 e cila është në likuidim ("N. Sh."): dhe

B Personi apo subjekti i identifikuar në Shtojcën 1 si Blerës ("Bleresi").

Historiku dhe Qëllimi

A AKP-ja në bazë të Neneve 6, 8 dhe 9 të Ligjit mbi AKP është e autorizuar të shesë Pronën e N. Sh.-së.

B Përmes një tenderi të hapur publik me oferta të mbyllura, Blerësi është zgjedhur nga AKP-ja si ofertues fitues për të blerë Pronën e N. Sh.-së.

C Blerësi është pajtuar të blejë pronën e N.Sh-së, sipas termave dhe kushteve të kësaj Kontrate.

REALIZOHET KONTRATA E MËPOSHTME:

**1 Përkufizime dhe interpretime**

1.1 Në këtë Kontratë (përfshirë Shtojcat), vlejnë përkufizimet e mëposhtme përveç nëse konteksti e kërkon ndryshe ose nëse shprehimisht parashihet ndryshe:

**"AKP"** nënkupton Agjencinë Kosovare të Privatizimit, (këtej e tutje "AKP") e cila është themeluar sipas Ligjit Nr. 03/L-067, mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit, të datës 21 Maj 2008, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-034. AKP është pasardhëse juridike e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit, e cila ka qenë e themeluar sipas Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2002/12, mbi Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit;

**"Barrë"** do ta ketë kuptimin e përcaktuar në Rregulloren mbi Tokën;

**"Çmimi i Blerjes"** nënkupton € 20,000 (njëzet mijë euro), që është i barabartë me çmimin e ofertës që Blerësi ka ofertuar për njësinë/asetin e tenderuar, në pajtim me procesin e tenderit sipas Rregullave të Tenderit;

**"Depozita e Ofertës"** nënkupton € 10,000 ( dhjetëmijë Euro), që është depozitë e ofertës të cilën Blerësi e paraqet me ofertën e tij, si pjesë e procesit të tenderimit sipas Rregullave të Tenderit;

**"Ditë Punë"** nënkupton ditët në të cilat punojnë institucionet publike të Republikës së Kosovës, përveç ditëve të cilat me ligj janë të caktuara si festa zyrtare;



D. G.

"Dhoma e Posaçme" nënkupton Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës e themeluar në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2002/13 të datës 13 Qershor 2002, "mbi themelimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për Çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit", e zëvendësuar me Ligjin Nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, për çështjet e ndërlidhura me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, apo çdo pasardhësi tjetër ligjor të Dhomës së Posaçme;

"Ligji mbi AKP" nënkupton Ligjin Nr. 04/L-034, të Kuvendit të Kosovës mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit, me të gjitha ndryshimet e mëvonshme;

"Ligji në Fuqi" nënkupton Kushtetutën e Republikës së Kosovës, ligjet dhe aktet nënligjore të miratuara në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin që ishte në fuqi në datën e hyrjes në fuqi të Kushtetutës, për aq sa të jetë në pajtueshmëri me Kushtetutën, derisa të mos shfuqizohet, zëvendësohet apo ndryshohen, në pajtueshmëri me Kushtetutën;

"Ligji për Dhomën e Posaçme" nënkupton ligjin me nr. 04/L-033 të shpallur me 31.08.2011 në G. Z. 20/22.09.2011 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, me të gjitha ndryshimet e mëvonshme;

"Llogari Bankare" nënkupton llogarinë në bankë të AKP-së, ku Blerësi ka depozituar shumën (në Euro) të barabartë me (1) Çmimin e Blerjes, pa (2) ndonjë Depozitë të Ofertës të paguar më parë nga Blerësi, në përputhje me Rregullat e Tenderit;

"N. Sh." nënkupton Ndërmarrje Shoqërore: "Produkti" (me numër regjistrimi në Gjykatën Ekonomike Fi. 727/89) (e njohur edhe si D.D. Produkt (me numër regjistrimi në Gjykatën Ekonomike Fi. 8163/92) dhe D.D. Produkt-Dijamant (me numër regjistrimi në Gjykatën Ekonomike Fi. 2694/94)), një Ndërmarrje Shoqërore e themeluar sipas ligjeve të Republikës Federale të Jugosllavisë apo çdo ligji tjetër në fuqi;

"Pronë" nënkupton kolektivisht, (1) Pronën e Paluajtshme dhe (2) Pronën e Luajtshme, nëse ka ndonjë, të paraqitura në Shtojcën 4;

"Pronë e Paluajtshme" nënkupton ngastra të caktuara toke dhe çfarëdo ndërtimet/ngrehine që ndodhet brenda kufijve të atyre ngastrave, mbi të cilën N. Sh.-ja e mban të drejtat e përdorimit te regjistruara ose jo, apo të drejta të tjera pronësore, posedimi apo përdorimi në përputhje me Ligjin në Fuqi, detajet e të cilave janë të përcaktuara në Shtojcën 2 të bashkangjitur;

"Qira" do ta ketë kuptimin e përcaktuar në Rregulloren mbi Tokën;

"Rregullat e Tenderit" nënkupton Rregullat e Tenderit për shitje të aseteve përmes një procesi konkurrues me oferta të mbyllura në pajtim me të cilin Blerësi ka dorëzuar ofertën e tij për Pronën dhe në përputhje me të cilin Blerësi është zgjedhur si Ofertuesi Fitues;

"Rregullorja mbi Tokën" nënkupton Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2003/13 Mbi Transformimin e të Drejtës së Përdorimit të Pronës së Paluajtshme Shoqërore (e ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2004/45 dhe Urdhëresën Administrative Nr. 2005/12), me të gjitha ndryshimet e mëvonshme.

1.2. Dispozitat e Shtojcave në këtë Kontratë janë pjesë përbërëse e kësaj Kontrate.

## 2 Kushtet e Shitjes së Pronës

2.1. AKP-ja, duke vepruar si administratore me mirëbesim në emër të N. Sh.-së, me anë të kësaj kontrate bart të gjitha të drejtat, titullin dhe interesat në Pronë nga N. Sh.-ja te Blerësi, në vartësi ose me përfitimin e të gjitha servituteve, të drejtave, marrëveshjeve, kufizimeve, qiramarrjeve, okupimeve dhe çdo barrë tjetër të çfarëdo lloji që e ngarkojnë Pronën dhe

ekzistojnë në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Kontrate, duke përfshirë por pa u kufizuar vetëm tek Qiratë për sa i përket Pronës së Paluajtshme të përcaktuar në Shtojcën 2.

2.2. Në rast se Qiratë transferohen sipas Shtojcës 2, atëherë këto Qira do t'i barten Blerësit në masën e lejuar me ligj. Blerësi pajtohet që do ta dëmshpërblejë tërësisht dhe do ta ruajë AKP-në dhe N. Sh.-në nga dëmi, nga dhe kundër të gjitha veprimeve, procedurave, shpenzimeve, ankesave, dëmtimeve dhe kërkesave kundër AKP-së apo N. Sh.-së të cilat mund të paraqiten si pasojë e ndonjë shkelje të qiradhënies nga Blerësi.

2.3. Përfundimi i transferimit i të gjitha të drejtave, titullit dhe interesave të Ndërmarrjes në Pronë, konsiderohet të ketë ndodhur me hyrjen në fuqi të kësaj Kontrate, përveç nëse specifikohet ndryshe me Ligjin në Fuqi.

2.4. Blerësi pajtohet dhe pranon të drejtat, titullin dhe interesat e N. Sh.-së mbi pronën "siç është", dhe në gjendjen në të cilën është në kohën e transferimit. Blerësi deklaron dhe garanton se nuk do të bëjë ndonjë padi kundër N. Sh.-së ose AKP-së lidhur me gjendjen faktike të pronës, ose ndonjë faktor tjetër që mund ta ndikojë atë, pavarësisht nëse gjendja e tillë apo faktori është i dukshëm, i vështirë për t'u zbuluar me inspektim të arsyeshëm, ose i fshehur dhe e pamundur për tu vërejtur.

2.5. Blerësi pajtohet se e blen Pronën (a) në varësi të ndonjë të drejte të pronësisë të paregjistruar që ka N. Sh.-ja në kohën e bartjes; dhe (b) pavarësisht nëse ngrehinat mbi Pronën e Paluajtshme janë ndërtuar apo jo, dhe/ose regjistruar në përputhje me Ligjin në Fuqi. Blerësi deklaron dhe garanton se nuk do të bëjë ndonjë padi kundër N. Sh.-së ose AKP-së lidhur me të drejtat, titullin dhe interesat e N. Sh.-se mbi Pronën e Paluajtshme.

2.6. Bartja bazuar në nenin 2.1 do të përfshijë bartjen e të gjitha të drejtave, titujve dhe interesave të N. Sh.-së mbi ndërtimet/ngrehinat në Pronën e Paluajtshme, përveç nëse shprehimisht përjashtohen në Shtojcën 3, pavarësisht nga ndonjë mospërputhje në mes të ndërtimeve/ngrehinave që aktualisht ekzistojnë dhe ndërtimeve/ngrehinave të detajuara në regjistrat e ngastrave kadastrale të paraqitura në Shtojcën 2. Blerësi deklaron dhe garanton që nëse ndonjë nga ndërtimet/ngrehinat mbi Pronën e Paluajtshme është ndërtuar në ndonjë mënyrë që nuk është në përputhje me procedurat dhe Ligjin në Fuqi, Blerësi do ta ruajë AKP-në dhe N. Sh.-në të padëmtuar për mospërputhjen e tillë.

2.7. Blerësi ka paguar Çmimin e Blerjes në Llogarinë Bankare dhe i ka paraqitur AKP-së dëshminë e pagesës.

## 3. Deklarimet dhe Garancitë

Blerësi deklaron dhe i garanton AKP-së dhe N. Sh.-së, se nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Kontrate:

3.1. (a) ka kompetenca dhe autoritet të plotë të hyjë në këtë Kontratë dhe t'i kryejë transaksionet e parashikuara në këtë mënyrë, (b) përfaqësuesi i tij për këtë Kontratë është i autorizuar në mënyrë të rregullt të ekzekutojë këtë Kontratë në emër të Blerësit; dhe (c) kur është entitet ligjor i inkorporuar në mënyrë të rregullt, dhe është në pozitë të mirë në juridiksionin e themelimit të tij;

3.2. blen Pronën për përdorim të vetin dhe me vullnetin e vet, dhe jo si agjent për ndonjë palë të tretë, dhe gjatë tenderit për këtë Pronë nuk ka hyrë në asnjë marrëveshje zyrtare apo jo-zyrtare me ndonjë ofertues tjetër ose me ndonjë palë tjetër;

3.3. (a) ka marrë dhe rishikuar çdo dokument për shitje të përgatitur nga AKP-ja i cili e përshkruan Pronën, dhe (b) është njoftuar nga AKP-ja për ekzistencën e Dosjes Elektronike



D.G

në lidhje me Pronën dhe N. Sh.-në (nëse është relevante) që përmban informacione të rëndësishme lidhur me Pronën dhe N. Sh-në (nëse është relevante) dhe i është dhënë mundësia të vizitojë Dosjen Elektronike dhe ai të vendosë vetë ta vizitojë ose jo Dosjen Elektronike në lidhje me Pronën dhe N. Sh.-në. Blerësi deklaron dhe garanton që ka rishikuar dokumentin e quajtur "Disa Rreziqe Ligjore dhe të Tjera" lidhur me Pronën dhe N. Sh.-në, që mbahet në Dosjen Elektronike;

3.4. ka bërë verifikimin paraprak lidhur me Pronën, N. Sh.-në dhe sistemin ligjor në Kosovë siç beson të jetë e duhur për qëllime të blerjes së parashikuar me këtë Kontratë, përfshirë por pa u kufizuar në kontrollimin e të dhënave publike, vizitimin dhe inspektimin e Pronës dhe hetimin e çështjeve, përfshirë por pa u kufizuar në lejet e ndërtimit e te tjera të ngjashme dhe çdo (1) uzurpim të Pronës (i përkohshëm apo ndryshe), dhe (2) ndërtimin e objekteve në Pronë, të ligjshme ose jo;

3.5. pranon se shumë ligje që zbatohen në Kosovë, janë shpallur relativisht kohëve të fundit, dhe kanë mundësi të interpretimit të ndryshëm, janë juridikisht të pa-testuar dhe për më tepër të dhënat/dokumentet në Kosovë mund të jenë të pakompletuara dhe të vjetërsuara.

## 4 Titulli

4.1 Blerësi do të pranojë të drejtat, titullin dhe interesat e N. Sh.-së mbi Pronën sipas gjendjes faktike në momentin e bartjes të Pronës te Blerësi dhe as AKP-ja e as N. Sh.-ja nuk do të japin ndonjë siguri ose garanci për vlefshmërinë e këtyre të drejtave, titullit dhe interesave.

4.2 Që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Kontrate, deri në kohën që bartja e ndonjë Prone nuk është përfunduar, AKP-ja do të mbajë Pronën e tillë në mirëbesim për Blerësin.

## 5 Të Tjera

5.1. N. Sh.-ja do t'i japë Blerësit ndihmë të arsyeshme me dokumente dhe informacione, në shpenzime të Blerësit, brenda fushëveprimit të N. Sh.-së dhe burimeve të kufizuara administrative të AKP-së më qëllim që kjo Kontratë të zbatohet (dhe AKP-ja do të bëjë përpjekje të arsyeshme për tu siguruar që N. Sh.-ja vepron kështu).

5.2. Sipas kërkesës së Blerësit, N. Sh.-ja do t'i ofrojë Blerësit ndihme me informacione e dokumente në mënyrë që Blerësi të arrijë bartjen efektive e të drejtave, titullit dhe interesave mbi Pronën (dhe AKP-ja do të bëjë përpjekje të arsyeshme për tu siguruar që N. Sh.-ja vepron kështu).

5.3. Kjo Kontratë do të hyjë në fuqi menjëherë pasi që të nënshkruhet nga Palët.

5.4. Pa paragjykime ndaj dispozitave tjera të kësaj Kontrate, secila Palë do të bartë taksat e veta dhe Blerësi do të bartë të gjitha përgjegjësitë dhe shpenzimet për kryerjen e ndonjë regjistrimi të paraparë me ligj të këtij transferimi, përfshirë por jo kufizuar në të dhënat kadastrale dhe merr përsipër të njoftoj autoritetet relevante (përfshirë ndonjë autoritet të taksave).

## 6 Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

6.1. Blerësi dhe AKP-ja (secila prej tyre "**Palë**", ose së bashku "**Palët**") do ta njoftojnë njëra-tjetrën me shkrim (përfshirë hollësitë e plota) menjëherë, për çfarëdo mosmarrëveshje që rrjedh nga ose në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e Palëve sipas kësaj Kontrate ose për shkeljen, vlefshmërinë ose ekzistencën e tyre. Brenda dhjetë (10) ditë pune, AKP-ja e cakton një periudhë të arsyeshme kohore dhe vendin për takim për të negociuar në mirëbesim zgjedhjen e mosmarrëveshjes.



D.G

6.2. Nëse këto mosmarrëveshje nuk zgjidhen brenda tridhjetë (30) ditëve të punës pas njoftimit të tyre:

6.2.1. Blerësi mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme, me kusht që AKP-ja të jetë njoftuar me kohë dhe në përputhje me Ligjin për AKP-në, Neni 30, dhe Ligjin për Dhomën e Posaçme..

6.2.2. AKP-ja mund që në cilësi të palës paditëse ose të palës së paditur të procedojë me padi në Dhomën së Posaçme.

6.3 Në pritje të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, Palët do t'i përmbahen detyrimeve sipas kësaj Kontrate pa paragjykuar vendimin përfundimtar të gjykatës.

7 Të përgjithshme

7.1 Kontrata e plotë. Kjo Kontratë së bashku me Rregullat e Tenderit e përbëjnë të tërë Kontratën në mes të Palëve lidhur me çështjet e përmendura këtu, dhe shfuqizon çdo marrëveshje/kontratë apo pajtim të mëhershme në mes të palëve ose secilin prej tyre në lidhje me shitjen e Pronës, dhe Palët pranojnë që asnjë pretendim nuk do të paraqitet lidhur me cilëndo marrëveshje apo pajtimin e shfuqizuar.

7.2 Veçimi. Nëse gjykata apo ndonjë autoritet tjetër kompetent vendos se ndonjëra prej dispozitave të kësaj kontrate është nule dhe e pa ekzekutueshme, ajo dispozitë konsiderohet e fshirë nga kjo Kontratë dhe dispozitat e mbetura të kësaj Kontrate do të vazhdojnë të jenë në fuqi dhe të efektshme. Pavarësisht nga faza paraardhëse, Palët do të negociojnë me mirëbesim, që të pranojnë një dispozitë të kënaqshme për të dyja palët që të zëvendësojë dispozitën që u konsiderua si nule apo e pa ekzekutueshme.

7.3 Mos heqja dorë. Asnjë vonesë apo lëshim, nga ana e AKP-së në ushtrimin e ndonjë të drejte, autoritet apo privilegj nuk do të ketë efekt në cenimin e kësaj të drejte, autoriteti ose privilegji, ose të interpretohet si heqje dorë nga ato dhe asnjë ushtrim i vetëm apo i pjesshëm apo mos ushtrim i ndonjë të drejte, autoriteti apo privilegji në asnjë rrethanë nuk do të përjashtojë ndonjë ushtrim të mëtejshëm të cilësdo të drejtë, autoriteti apo privilegji.

